



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2024:113135  
Datë: 24.05.2024  
Numri i dokumentit: 05732647

CA.nr.5075/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc. Rafet Haxhaj, kryetar dhe Enes Mehmeti e Naim Mehulli anëtarë, me zyrtares ligjore Fitore Isufi-Saraçi, në çështjen juridike paditësit – propozuesit “D...”, të cilin e përfaqëson A. Sh, avokat nga Mitrovica, kundër të paditurit – kundër-propozuesja Komuna e Mitrovicës me seli në Mitrovicë, për pengim posedimi, me propozim për caktimin e masës së sigurisë, duke vendosur sipas ankesës së propozuesit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë C.nr.1814/2024 të datës 25.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 23.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET si e pa bazuar, ankesa e paditësit – propozuesit “D...”, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë C.nr.1814/2024 i datës 25.04.2024, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

**Historiku procedural:**

Me aktvendimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, refuzohet si i pabazuar propozimi i paditësit – propozuesit të sigurimit paditësit– propozuesit “D...”, nga Mitrovica, ashtu që të paditurit-kundër propozueses Komuna e Mitrovicës, i ndalohet Kundërshtarit te propozimit te sigurimit qe ne drejtim te parcelës kadastrale me nr. 3546-35, Zona Kadastrale ne Mitrovicë, ne vendin e quajtur “...”, me sipërfaqe te përgjithshme prej 727 m<sup>2</sup>, te kryej çfarëdo aktiviteti me qellim te ruajtjes se gjendjes ekzistuese dhe pengimit te dëmtimit te Propozuesit.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur propozuesi i sigurimit për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e propozuesit si e bazuar, të prishet aktvendimi i atakuar dhe çështja kontestimore të vendoset në mënyrë meritore.

### **Gjetjet e Gjykatës së Apelit**

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, dhe pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194, 208 dhe 209 të LPK -së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi-propozuesi "D..." ka parashtruar padi me propozim për caktimin e masës së sigurisë, ndaj të paditurës-kundërpropozueses Komuna e Mitrovicës, me të cilën ka kërkuar që të t'i ndalohet Kundërshtarit te propozimit te sigurimit qe ne drejtim te parcelës kadastrale me nr. 3546-35, Zona Kadastrale ne Mitrovicë, ne vendin e quajtur "...", me sipërfaqe te përgjithshme prej 727 m<sup>2</sup>, te kryej çfarëdo aktiviteti me qellim te ruajtjes se gjendjes ekzistuese dhe pengimit te dëmtimit te propozuesit.

Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e aktvendimit të atakuar me ankesë.

### **Baza ligjore:**

Neni 194 i LPK-së: "Gjykata e ankimit ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi , pika b), g), j), k), dhe m) të këtij ligji".

Neni 195.1 i LPK-së: "Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj: .....d) ta refuzojë ankesën si të pa themeltë dhe ta vërtetojë aktgjykimin e goditur".

Neni 209 par.1 i LPK-së: “Duke vendosur për ankimin e veçantë, gjykata e shkallës së dytë mund: ....b) të refuzoj ankesën si të pa themeltë dhe e vërteton aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë”.

### **Vlerësimi i Gjykatës së Apelit:**

Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të ligjshëm e miraton në tërësi kolegji i Gjykatës së Apelit, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore e për të cilat shkaqe gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare, dhe se në rastin konkret është bërë zbatimi i të drejtës materiale në mënyrë të drejtë. Në vendim janë dhënë arsye të mjaftueshme të cilat i pranon dhe kolegji i gjykatës së shkallës së dytë.

Nga ankesa e ushtruar e palës prozuese Kolegji i Gjykatës së Apelit gjen se, kundërpropozuesja dhe prozuesi me datë 01.07.2011 kanë lidhur kontratë me numër Nr.033/2011-1 për Dhënie në shfrytëzim të hapësirës prej 727.21m<sup>2</sup> të ... në Mitrovicë. Me anë të nenit 14.2 të kontratës së lartpërmendur është përcaktuar afati i kësaj kontrate i cili është 10 vite nga data e nënshkrimit, me mundësi vazhdimi me pajtimin e të dy palëve kontraktuese. Rrjedhimisht prozuesi ka pasur të drejtë shfrytëzimi në hapësirën kontestuese deri me datë 01.07.2021. përkundër skadimit të kontratës nr.033/2011-1 të datës 01.07.2011, prozuesi ka vazhduar që të mbaj në shfrytëzim hapësirën kontestuese me keqbesim dhe pa ndonjë bazë të ligjshme. Kundërpropozuesja, konkretisht Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Mitrovicës së Jugut ka nxjerrë vendimin me nr. të protokollit Nr.12-030/02-0094583 të datës 17.10.2022, me anë të cilit ka urdhëruar prozuesin që të liroj hapësirat në “...”. Në bazë të këtij vendimi vërtetohet fakti se kundërpropozuesja nuk ka shprehur vullnetin që kontrata Nr.033/2011-1 e datës 01.07.2011 të vazhdohet. Në bazë të vendimit Nr.12-030/02-0094583 të datës 17.10.2022, Drejtoria për Inspeksion pranë kundërpropozueses ka inspektuar hapësirën kontestuese të cilën është duke e shfrytëzuar prozuesi dhe i ka kërkuar prozuesit që ta liroj këtë hapësirë duke bërë largimin e objektit me konstruksion metalik të cilin e ka vendosur në hapësirën në fjalë. Pasi që prozuesi nuk ka vepruar sipas urdhrave të evidentuara në procesverbalin e lartpërmendur, Drejtoria për Inspeksion pranë kundërpropozueses ka nxjerrë aktvendim me numër 05 Nr.354/01-0021120/23 të datës 09.03.2023 me të cilin prozuesi është urdhëruar që në afat prej 15 ditëve pas pranimit të këtij aktvendimi të bëjë lirimin e pronës komunale-lokalin në “...” si dhe rrënimin e lokalit me dimensione 10x15 metra, ngjitur për të njëjtin lokal. Për të ekzekutuar aktvendimin e lartpërmendur, Drejtoria për Inspeksion pranë kundërpropozueses ka nxjerrë Vendimin për Ekzekutimin e Aktit Administrativ 05 Nr.354/01-

0021120/23-2 të datës 05.02.2024 dhe me këtë aktvendim është përcaktuar që të bëhet ekzekutimi i aktvendimit në fjalë me datën 11.02.2024 në ora 9:00. Me këtë vendim është njoftuar propozuesi. Kundër aktvendimit 05 Nr.354/01-0021120/23 të datës 09.03.2023, propozuesi kishte parashtruar ankesën e datës 23.03.2023, mirëpo ankesa e tij është refuzuar nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave pranë Kundërpropozueses me anë të Vendimit me numër 05-354/01-0021120/2/23 të datës 05.04.2023. në këtë vendim Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave, ndër të tjerash ka arsyetuar që Vendimi i Drejtorisë së Inspeksionit duhet të zbatohet për arsye se është duke u penguar realizimi i projektit për renovimin e ..., investim ky i mbështetur me donacion nga MCC, shoqatë e krijuar nga Kongresi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Drejtoria për Inspeksion pranë kundërpropozueses ka nxjerrë gjithashtu Vendimin për Ekzekutimin e Aktit Administrativ 05 Nr.354/01-0021120/23-3 të datës 11.04.2024. Duke vepruar sipas këtij Vendimi, Drejtoria për Inspeksion pranë kundërpropozueses me datë 17.04.2024 ka ndërmarrë veprimet e nevojshme duke i vendosur shiritat në hapësirën kontestuese.

Kolegji miraton vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë se nuk janë plotësuar kushtet e përcaktuara me nenin 297 të LPK-së, për caktimin e masës së sigurimit, për arsye se pala propozuese e sigurimit nuk e ka bërë të besueshëm ekzistimin e rrezikut real se pa caktimin e masës së propozuar, pala propozuese e sigurimit do të pësoj dëm të pa riparueshëm dhe se me këtë do të vështirësohej dukshëm realizimi i kërkesës. Për më tepër Kolegji i Gjykatës së Apelit gjen se pala propozuese e sigurimit nuk ka ofruar argumentimin se ka ndjekur rrugëtimin e kontestimit administrativ të akteve të tilla. Në nenin 304.3 të LPK-së përveç tjerash është parashikuar që *propozuesi duhet ti tregoj edhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesa e tij, si dhe të propozohen mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim, dhe që këto mjete provuese t'ia bashkëngjisë propozimit.* Kolegji gjen se pala propozuese e sigurimit nuk ka argumentuar se në çka konsiston ekzistimi i rrezikut dhe vetë dëmi i pa riparueshëm për propozuesin e sigurimit. Në nenin 319.1 të LPK-së është parashikuar që secila nga palët ndërgjyqës ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet e veta. Meqenëse, pala propozuese nuk ka bërë një gjë të tillë, kolegji ka vlerësuar se nuk qëndrojnë pretendimet e palës propozuese të parashtruara në propozimin mbi masën e sigurimit, pretendimet ankimore i ka refuzuar si të pa bazuara dhe ka bërë vërtetimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Numri i lëndës: 2024:113135  
Datë: 24.05.2024  
Numri i dokumentit: 05732647

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 195 par.1 pika d) dhe 209 par.1 pika b) të LPK-së, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
CA.nr.5075/2024, me datë 23.05.2024

Kryetari i kolegjit - gjykatësi,  
Dr.sc. Rafet Haxhaj